



INOVACIONET E MITROVICËS



UNLOCKING

YOUTH

POTENTIAL

UDHËZUES

PËR TË JU

NDIHMUAR NË PLANIFIKIMIN

E KARRIERËS SUAJ



International
Business College
Mitrova

From Theory To Practice



From Theory To Practice

IBCМ është mirënjohës sponsorëve bujar të Inovacioneve të Mitrovicës në vitin 2016: Konferenca e Zbulimit e Potencialit Rinor.



British
Embassy
Pristina



From Theory To Practice



Ministry of Foreign Affairs



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Caktoni Qëllimet	5
Shkollimi	6
Zhvilloni Shkathësitë Tuaja	7
Fitoni Përvojë Praktike	8
Jini Profesional	9
Jini Inovativ	10
Ndërtoni Rrjete	11
Rrezikoni	12
Këmbngulni	13
Mundësia Po Ju Pret!	14
Rreth Nesh	15

Ky udhëzues është udhërrëfyes për të ardhmen tuaj. Tani keni në dorë një mori veglash që do të ju ndihmojnë të planifikoni dhe ndërtoni një karrierë të suksesshme. Është hartuar posaqërisht për të rinjtë nga rajoni juaj.

Lexojeni me kujdes, dhe ruajeni përgjithmonë!

Nëse jeni person i ri nga Ballkani, tashmë e dini se rrugëtimi juaj drejt suksesit nuk është i lehtë. Sfidat përfshijnë sistemin arsimor që nuk është i suksesshëm në ndërtimin e shkathtësive për botën reale të punës, mungesën e modeleve reale të rolit, çasja e kufizuar në këshillimet për karrierë, si dhe përkrahja e mangët për ndërmarrësi. Edhe kur të futeni në tregun e punës; ekzistojnë edhe më shumë pengesa: kolegët mund të mos ju përkrahin, obligimet nga kontratat dhe marrëveshjet nuk respektohen, ka papërgjegjësi për veprimet e kryera, ose korrupsioni.

Prandaj, kur studentët dhe të diplomuarit e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (IBCM) shpalosën idenë për konferencën INOVACIONET E MITROVICËS 2016 - ZBULIMI I POTENCIALIT RINOR, ata dëshironin të përdorin diskutimet mes të rinjëve, profesionistëve lokal dhe ekspertëve rajonalë për të krijuar një Udhëzues unik për të ju përshtatur këtij mjedisi specifik, dhe për të ju ndihmuar kolegëve të realizojnë ëndrrat e tyre.

Ditën e konferencës pati shumë këshilla të mira, dhe në fakt, kishte shumë arsye premtuese. Porosia që të rinjtë e morën në INOVACIONET E MITROVICËS 2016 – ZBULIMI I POTENCIALIT RINOR ka qenë shumë pozitive. Kishte diskutime dhe biseda dinamike rreth natyrës së ndryshimit të tregut aktual të punës, si dhe mundësitë që presin të shfrytëzohen në një ekonomi të pazhvilluar.

Profesionistët dhe ekspertët ua përkujtuan audiencës rinore se secili prej tyre është i bekuar me potencial, që pret të realizohet. Këshilla kryesore ishte: nëse ndiqni qëllimet tuaja dhe nuk dorëzoheni edhe kur gjërat vështirësohen, do të befasoni se çka mund të arrini!





Kishte edhe fjalime frymëzuese nga të rinjtë; dëgjuam nga të diplomuarit e IBCM-së të cilët tashmë kanë arritur sukses në karrierat e tyre; studentët që ndanin rrëfimet e tyre se çfarë kanë mësuar gjatë punës vullnetare ose pjesëmarrjes në iniciativat rinore; si dhe profesionistë të rinj që kanë përjetuar përvoja të dorës së parë se çfarë duhet bërë për ta bërë ëndrrën realitet. Dhe, për të dëshmuar mundësinë e të rinjëve për të bërë ndryshime, vet konferenca drejtohej dhe koordinohesh nga studentët dhe të diplomuarit e IBCM-së.

Zbulimi i Potencialit Rinor: Ky udhëzues grumbullon përvojat e ndara në konferencën **INOVACIONET E MITROVICËS 2016 – ZBULIMI I POTENCIALIT RINOR** në formën e një udhëzuesi praktik që mund ta mbani përgjithmonë. Nëse keni marrë pjesë në këtë ngjarje, mund ta shihni edhe idenë tuaj, rrëfimin apo citatin e shfaqur në njërin prej faqeve të këtij udhëzuesi! Ky udhëzues është autentik dhe unik, dhe gjithçka në këto faqe është 100% relevant për të rinjtë e këtij rajoni.

Shpresojmë që do ta përdorni për frymëzim, motivim si dhe do të ju ndihmoj në rrugëtimin drejt zbulimit të potencialit tuaj!

CAKTONI QËLLIMET

Caktimi i qëllimit është një vegël e fuqishme që ju qon drejt së ardhmes ideale dhe zbulon potencialin tuaj. Duke e ditur saktësisht se çfarë dëshironi të arrini, ju dini se ku t'i përqëndroni përpjekjet. Pjesa e vështirë është caktimi i qëllimeve që balancojnë sfidimin dhe arritjen. Nëse i caktoni drejt, ju keni një vegël të fortë për të arritur jetën që dëshironi. Por, si ta bëni këtë?

- **Jini të vetëdijshëm:** Të qenurit i vetëdijshëm nënkupton që e dini se kush jeni, mënyrën se si silleni, dhe si ndikojnë sjelljet tuaja tek të tjerët. Nuk keni nevojë që të orvateni të bëheni dikush që nuk jeni! Njerëzit që janë të vetëdijshëm se kush janë kanë mundësi të besojnë në ndryshime, dhe e kuptojnë se ku duhet të përmirësohen.
- **Caktoni "shtytësin" tuaj:** Disa njerëz vlerësojnë punën sfiduese më shumë sesa paratë; disa njerëz caktojnë si prioritet punën e pavarur kundrejt punës në grup. Zbuloni se çka ju motivon!
- **Jini realist se çka mund të arrini:** Kuptojeni se çka mund dhe çka nuk mund të arrini – dhe jini të sigurtë me vetveten rreth punës që duhet të bëni për të arritur synimet tuaja, si dhe sfidat apo barrierat e mjedisit tuaj.
- **Caktoni qëllimet e vogla drejt rrugëtimit si të mëdha:** Kjo do të ju ndihmojë të gjurmoni progresin dhe ju jep ndjenjën e arritjes për të ju mbajtur të fokusuar dhe motivuar në afat më të gjatë kohor!
- **Mos humbisni kohë:** Jeta është shumë e shkurtër për ta kaluar tërë ditën në rjetet sociale! "Gjithçka është e mundur nëse kemi vullnetin për ta bërë"

"Nuk mund ta ndiqni ëndrrën nëse nuk keni asnjë!"

KËSHILLË E DOBISHME:

Mbani shënime! Mbajtja e qëllimeve afatgjate të karrierës në letër mund të ju ndihmojë t'i ktheni ato në realitet! Përgatiteni një listë të qëllimeve afatshkurtra që do të ju ndihmojnë t'i arrini ato afatgjata, dhe kontrollojeni listën rregullisht.



Është e qartë, por nëse bëni zgjedhjet e duhura në lidhje me shkollimin atëherë kjo do të ndikoj në tërë jetën tuaj. Në një sistem ku mund të ndiheni sikur shkollat dhe universitetet fokusohen në gjërat e gabuara, kërkoni mundësi dhe institucione që do të rrisin potencialin tuaj, sipas qëllimeve tuaja personale.

Pse ka rëndësi?

“Shkolla është sikurse një fener deti: një formë orientimi”

- **Zakonet e tërë jetës:** Ju jeni student për tërë jetën; shkollimi ju pajis me veglat për të ju mbajtur në mësim gjatë gjithë karrierës.
- **Dituria është fuqi:** Ata që dijnë se si të përdorin diturinë sot janë po ata që bëhen liderë dhe vendimmarrës nesër.

“Tre shkathtësitë kryesore të transferueshme që i kam marrë nga diploma ime e parë janë shkathtësitë e hulumtimit; si ta bëjmë një prezantim; dhe si ta shkruajmë një raport. Këto janë tre gjërat që i bëjë gjithmonë, në biznesin tim”.

Ku të studioni? Zotërimi i përvojës praktike mund të jetë shumë përparësi në tregun rajonal të punës. Zgjedhja e një institucioni shkollor që vlerëson punën praktike mund të jetë një hap shumë i rëndësishëm para.

Modeli i të mësuarit në **Kolegjin Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë** – pse është ndryshe?



1. Fokus në biznes dhe menaxhment
2. Më pak përshkrues, më shumë praktikë: përvojë reale e punës përmes praktikave obligative
3. Theksimi në arritjen e shkathtësive analitike dhe zgjidhjes së problemeve
4. Kualifikim i nivelit ndërkombëtar relevant me kontekstin lokal
5. Inkurajon inovacionin dhe mendimin e pavarur
6. Mundësi për të arritur lidhje reale për karrierë në të ardhmen

ZHVILLONI SHKATHTËSITË TUAJA

Shkathtësitë tuaja janë fushat e ekspertizës që ju tregojnë njerëzve se çfarë mund të bëni. Punëdhënësit dëshirojnë të dijnë shkathtësitë tuaja në mënyrë që të shohin se si mund t'i ndihmoni biznesit të tyre. Kuptojini shkathtësitë dhe talentet që i keni – dhe mbani mend që “shkathtësitë e lehta”, si të qenurit i organizuar ose i mirë me të tjerët mund të jenë po aq të dobishme sikurse “shkathtësitë e forta” si IT apo gjuha e dytë.

Çfarë shkathtësish ju interesojnë punëdhënësve?

- Gjuhët, posaqërisht anglishtja!
- IT dhe pakaja Microsoft Office
- Shkathtësitë kreative – fotografia, dizajni, shkrimi
- Shkathtësitë numerike – financat, kontabiliteti
- Lidershipi
- Shkathtësitë e punës me të tjerët



Megjithatë, të gjitha shkathtësitë janë të dobishme diku!

KËSHILLE E DOBISHME: Bëjeni një “Vlerësim të Shkathtësive” për veten – shkruani gjithçka që mendoni se janë pozitive – dhe pyesni miqtë dhe familjarët për mendimin e tyre, gjithashtu! Cilat shkathtësi mund t’i shisni tek punëdhënësit? Krahasoni ato me listën e qëllimeve dhe mendoni se ku duhet të përmirësoheni.



Si mund të ndërtoni shkathtësitë tuaja?

- Kryeni internshipe në organizata (Shif faqen 8)
- Ndjekni trajnimet lokale. Shumë OJQ, ambasada, dhe institucione tjera lokale mbajnë trajnime dhe punëtori.
- Ndiqni kurset! Kurset e gjuhës, kurset e TIK, kurset e vozitjes - lejoi hobot dhe interesat tuaja të jenë shtytje në profesionin tuaj
- Mermi pjesë aktivisht në klube dhe shoqata. Rolet e lidershipit në këto grupe mund të jenë përvoja të mira.

“Derisa studioja në IBCM kam ndjekur të gjitha trajnimet dhe punëtoritë e ofruara nga SPARK dhe OJQ-ve të tjera. Shkathtësitë që kam zhvilluar më kanë ndihmuar të impresionoj punëdhënësit dhe kam arrit të ndjek karrierën që kam dëshiruar”

“Flas tre gjuhë rrjedhshëm, dhe kjo shkathtësi më mundëson që të punësohem si përkthyes. Duke pas shkathtësi që të tjerët nuk i kanë, ju ofron shumë përparësi.”

FITONI PËRVOJË PRAKTIKE

Bota e punës dallon prej shkollave ose kolegjeve. Ekzistojnë pritje të ndryshme, dhe mënyra të komunikimit. A e dini se si funksionojnë hierarkitë organizative? Apo si të dërgoni një email biznesi? Përvoja e punës praktike është mënyra e duhur për të fituar njohuri të tilla, dhe është shpesh parësore për të impresionuar punëdhënësit.

Cili lloj i përvojës është i dobishëm?

- Të gjitha! Gjeneroni një punë, qoftë vullnetare, internship apo merrni pjesë në ndonjë ngjarje, jini aktiv në klube dhe shoqëri. Kjo tregon se merrni iniciativë!
- Në bizneset e vogla ju mund të punoni me bordin dhe të ndikoni në vendime, kurse në organizata të mëdha ju mund të shifni se si funksionojnë sistemet e efiçencës. Proveni të dyja!



Çfarë fitoj nga kjo?

- Zhvilloni shkathtësitë ekzistuese dhe fitoni shkathtësi të reja
- Krijoni lidhje të mira (ndërtoni rrjetin! Shif faqen 11)
- Nuk keni nevojë të gjeneroni motivimin në tekste apo libra shkollor – bota reale mund të jetë shumë më inspiruese!
- Është e dobishme edhe për ndërmarrësit e rinj gjithashtu, për shkak se vendosni se si dëshironi të duket biznesi juaj.

Ku i gjeneroni këto mundësi?

- Informohuni. Shiqoni pozitat në universitet apo në ueb faqet e punësimit apo njoftimet në tabela.
- Mos u dekurajoni nga internshipet pa pagesë – përvoja e fituar do të jetë shumë e vlefshme.
- Dërgoni CV-në dhe letrën motivuese tek organizatat dhe kompanitë e ndryshme dhe shfaqni interesimin tuaj për punë! Nganjëherë kjo funksionon edhe nëse nuk ka pozicione të lira!

“Kam filluar të punoj në ProCredit si praktikant në semestrin e 4-të derisa studioja në IBCM, dhe më ka pëlqyer çasja, mjedisi dhe vizioni. Pasi kam kryer internshipin, kam ndjekur programin e trajnimit 6 mujor plotësisht në gjuhën angleze, dhe tani jam punësuar në bankë”.

JINI PROFESIONAL

Tashmë e dini që është shumë me rëndësi të jini profesional nëse dëshironi të keni karrierë të suksesshme, por çka do të thotë kjo? Pas së gjithash, profesionalizmi mësohet shumë rrallë; ju duhet ta mësoni vet atë gjatë rrugëtimit tuaj, përmes vrojimit dhe praktikës. Ja disa këshilla për profesionistët aspirues!

Jini serioz: Qëndrimi është i rëndësishëm. Është e vështirë të gjesh njerëz të besueshëm dhe serioz. Shfaquni me kohë dhe rregullisht, dhe mbani premtimet. Është shumë me rëndësi t'i njoftoni njerëzit nëse nuk mund të bëni diçka – është shumë më profesionale të jesh i sinqertë sesa të përpiqeni të mbulojeni! “Nëse thoni se do ta thirrni klientin në ora 8 në mëngjes, atëherë bëjeni këtë”

Jini të përgjegjshëm: Jini të dobishëm, bëni më shumë se që ju përshkruhet në pozitën e punës, dhe mos u mbështetni tek të tjerët për të bërë gjithçka, apo të fajësoni të tjerët kur gjërat shkojnë keq. Nëse e bëni ndonjë gabim apo kur diçka nuk shkon mirë, pranoni përgjegjësinë – njerëzit do të jenë më të lumtur të ju lavdërojnë kur arrini sukses!

Angazhohuni: Fokusohuni në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjate dhe mbajini konsumatorët të kënaqur. Kjo është e rëndësishme për suksesin e biznesit por shpesh jo prioritet për njerëzit dhe bizneset e reja.

Jini pragmatik: Jini i sjellshëm me njerëzit, edhe nëse nuk ju pëlqejnë. Kuptojeni që marrja e kritikave është e mirë për zhvillimin tuaj. Jini fleksibil. Po, dita juaj e punës mund të mbaroj formalisht në orën 5 pasdite, por nëse ju duhet të qëndroni më gjatë për të kryer punën, atëherë bëjeni atë!

Filloni herët: Mendoni për gjithçka që bëni tani si përgatitje për të ardhmen tuaj. Kjo përfshinë ndërveprimet me mësimdhënësit tuaj, shefin, liderët e komunitetit, miqtë dhe njerëzit e afërm, që mund të jenë kolegë apo partnerë në të ardhmen!

KËSHILLË E DOBISHME: A e njihni dikë që është gjithmonë profesional, dhe gëzon respektin e të gjithëve? Shikojeni me kujdes. Mendoni se si ata e udhëheqin veten dhe si i përgjigjen situatave të caktuara.



Inovacion do të thotë të bësh diçka të re, ose të bëni ndryshime në diçka që është zbuluar tashmë. Në tregjet në zhvillim, keni shumë mundësi të jeni personi i cili bënë diçka ndryshe – ose duhet të jeni mjaft guximtar për të kapur mundësinë!

Shikoni problemet që kërkojnë zgjidhje: Kini parasysh botën rreth jush. Çka funksionon? Çka nuk funksionon? A mendoni ndonjëherë: “po sikur ta bënte dikush këtë!” ose “dikush duhet ta ndreq këtë!”? Ai dikush mund të jeni ju! “Bujaësia është një segment i nënvlerësuar i ekonomisë lokale. Ekzistojnë shumë mundësi për inovacion, dhe përfundimisht për të qenë i suksesshëm dhe të fitoni para, por shpesh injorohet. Unë dëshiroj të jem personi që e shfrytëzon këtë shansë!”

Theni rregullat! Bizneset nuk rriten duke bërë gjërat e njëjta, dhe poashtu as ju. Natyrisht, ju duhet të dini rregullat shumë mirë para se t'i theni ato, por pasi t'i keni thyer, shtyrja e kufijve dhe bërja e të pamundurës mund të qoj në vende shumë interesante!

“Nuk keni mundësi të ndryshoni lojën nëse nuk i dini rregullat”

Veproni shpejt dhe me vendosmëri: Nuk është mirë të keni vetëm ide – ju duhet të veproni. Nganjëherë solucionet më të thjeshta kanë ndikimin më të madh!

“Kam parë një zbrastësi në treg, dhe kam vendosur që unë do të jem ai që do ta plotësoj atë”

“Teknologjia e re ofron mundësi të panumërta – sfida është që ta bëni ju i pari para se dikush ta bëjë”



“Rrjeti” mund të tingëlloj shpesh si një zhargon abstrakt biznesi, por vërtetë, është shumë i thjeshtë. Rrjetet thjeshtë kanë kuptimin e lidhjeve me njerëzit që mund të këshillojnë, bashkëpunojnë dhe të ju përkrahin në biznes apo karrierë.

Rrjetet ju ndihmojnë të plotësoni zbrastësit: Ju vetëm mund të mos i keni shkathtësitë që ju nevojiten për të qenë i suksesshëm – por të tjerët i kanë! “Kam hapur një biznes bujqësor. Bujqësia është fusha ime e ekspertizës. Megjithatë, nuk kam njohuri biznesi apo marketingu që më nevojiten për t’u siguruar që biznesi im të mbijetoj. Më duhet një rrjet njerëzish që më ndihmojnë dhe ofrojnë këto shkathtësi”.

Kuptojeni fushën tuaj: Rrjetet mund të ju ndihmojnë që të kuptoni më mirë botën e punës derisa ende jeni duke u shkolluar, dhe ju ndihmojnë që të jeni një hap para turmës kur të filloni. “Rrjeti është shumë i rëndësishëm, gjithçka është e lidhur. Në biznes duhet të ndiqni trendet; të dini se çfarë bëjnë bizneset tjera”.

Ku mund t’i takoni njerëzit që mund të bëhen pjesë e rrjetit tuaj?

- Universitet
- Puna praktike
- Punë
- Trajnime
- Punë vullnetare

Megjithatë – mund të krijoni lidhje të mira kudo! Gjithmonë duhet të kërkoni njerëz interesant për t’u lidhur (andaj sjellja profesionale është shumë e rëndësishme – shif faqen 9 !).



“Të rinjtë kanë nevojë për rrjete të forta që të mund të tejkalojnë grackat me të cilat përballen si mungesa e burimeve, si financiare ashtu edhe të shkathtësive”

Rrjete jo nepotizëm: Mbani mend – lidhjet nuk janë gjithçka! Bizneset vazhdimisht kërkojnë njerëz me cilësi që mund të dëshmojnë shkathtësitë e tyre, jo vetëm njerëz që vijnë nga dera e pasme.

RREZIKONI

Do të kuptoni se duhet të vendosni të bëni diçka ndryshe në mënyrë që t'i përmbushni qëllime tuaja. Rrezikimi mund të duket i tmerrshëm, për shkak se ekziston gjithmonë diçka e frikshme – por ka edhe gjëra të mira që mund të përfitoni! Përfitimi nga marrja e hapave pozitiv dhe rreziqeve të kalkulueshme do t'ju pasuroj jetën dhe do ta bëjë biznesin apo karrierën tuaj më të dobishme.

“Nganjëherë duhet të rrezikoni gjithçka”

Natyrisht, ekzistojnë rreziqe të mëdha, sikur investimi i parave dhe kohës, apo zhvendosja në një vend të ri, por ekzistojnë edhe rreziqe të vogla që duhet të marrim gjatë karrierave tona.

Qëndrojni besnik vlerave: Ekzistojnë kohëra kur kolegët apo rrethanat do t'i vënë në pikëpyetje parimet tona. Mund të duhet më e rrezikshme që t'i qëndroni besnik vlerave në të cilat besoni, por në një periudhë afatgjate, njerëzit do të ju respektojnë më shumë.

Sfidimi i normave: Mos e pranoni status quo-në! Nëse mendoni se gjërat duhet bërë ndryshe, luftoni për këtë!

Puna jashtë zonës juaj komode: Është e lehtë të bëni çka dini – por nuk do të zhvilloheni apo rriteni nëse i bëni gjërat e njëjta vazhdimisht. Pranoni sfidat, bëni gjëra që janë përtej kapacitetit tuaj.

Bëni diçka për të cilën ndiheni se nuk jeni të kualifikuar ta bëni: mbani mend që jeni i ri dhe keni shkathtësi të ndryshme dhe perspektiva që janë të vlefshme!

Keni besim në kontributet tuaja unike: Punëdhënësit që nuk janë mjaft të mençur për të parë vlerat që mund t'i shtoni biznesit të tyre nuk ja vlejnë të punohet për ta!

“Në ditët e hershme të karrierës sime, më është kërkuar që të bëjë një prezantim për njerëzit që ishin shumë më të kualifikuar se unë. Isha shumë nervoz, por pastaj një koleg më përkujtoi që rinia ime nënkuptonte se kisha një perspektivë të freskët dhe ndryshe për të ofruar, dhe kjo më ndihmoi që të besoj se ja kishte vlejtur të ndëgjoja.”

“Mos u dorëzoni!” Kjo është porosia nga ekspertët që e kemi dëgjuar disa herë. Gjithkush përballet me sfida apo vështirësi – është gjë e pashmangshme. Por pa marrë parasysh a keni filluar tani, jeni në mes të rrugëtimit të karrierës, ose po përpiqeni të ndërtoni diçka të re vet, të qenurit në gjendje të ngriteni kur rrëzoheni është gjë parësore për suksesin tuaj.

Ekzistojnë dy rrugë: rruga e vështirë dhe rruga shumë e vështirë: Mos prisni se do të jetë e lehtë. Të qenurit realist rreth faktit se do të përballenit me pengesa dhe probleme do të ju ndihmojë të përballenit me ato posa të shfaqen.

Do të ju duhet të trokisni në 100 dyer për të hapur një ose dy: Mos u thyeni nga refuzimi – do të ketë ndonjë organizatë që do të jua hap derën. (Por, nëse trokisni në 200 dyer, dhe nuk keni rezultat, atëherë është mirë të ndryshoni strategjin!)

Duhet të gaboni që të mësoni: Kohërat e vështira janë ato nga të cilat mund të mësoni më së shumti. “Kam dështuar disa herë gjatë procesit të operimit të biznesit, por nuk jam dorëzuar se kam pasur pasion dhe angazhim, dhe në fund, këto përvoja më kanë ndihmuar që të krijoj një biznes më të mirë”

Niqeni qëllimin tuaj derisa të arrini sukses: Të vazhdoni tutje derisa përballenit me sfida dhe pengesa është ajo që e definon personin e suksesshëm. “Në fillim, natyrisht ka qenë e vështirë, por talenti i vetëm që kam është se nuk dorëzohem kurrë”

“Sfida më e madhe që kam hasur gjatë themelimit të biznesit im ka qenë sigurimi i ndihmës financiare, për shkak se shumë institucione nuk më kanë marrë seriozisht. E kam tejkaluar këtë pengesë duke qenë këmbëngulës duke u'a dëshmuar agjensioneve financiare që ideja ime është e qëndrueshme dhe zgjedh një problem shumë të madh për të rinjtë”



MUNDËSIA PO JU PRET!

Edhe pse shumë njerëz ëndërrojnë që të realizojnë suksesin e tyre jashtë vendit, ekzistojnë edhe shumë argumente që duhet të qëndroni në vend dhe të përdorni shkathtësitë dhe talentin tuaj për të ndihmuar ndërtimin e ekonomisë lokale. Energjia që nevojitet për t'u adaptuar në një vend të ri është e madhe, dhe nuk është gjithmonë e lehtë të gjesh një vend pune ku mund të kontribuoni në mënyrë të duhur tek ajo shoqëri. Vetëm mendoni – nëse e investoni atë energji në shoqërinë tuaj, ju mund të sjellni sukses jo vetëm për veten tuaj, por për familjen, komunitetin dhe më gjërë!

- **Moszhvillimi nënkupton mundësi:** Për ata që angazhohen për ta gjetur atë, tregu aktual në Ballkan është plot mundësi për ndërmarrësit për të sjellur dhe ofruar mallra dhe shërbime.
- **Dallohuni:** tregu i Ballkanit është i orientuar kah shitja. Ekziston një zbrastësi e madhe për një fokus në rritje ndaj konsumatorit. Ata që i përkushtohen parimeve për një çasje të orientuar kah shërbimi i konsumatorit kanë shansa të dallohen.
- **Mendoni përtej kufijve:** Mundësitë shpesh nuk gjenden në vendet e zakonshme. Bujqësia dhe prodhimi ushqimor kanë potencial të jashtëzakonshëm për zhvillim në rajon por tregu nuk është shfrytëzuar aspak. Ata që janë mjaft të guximshëm për të eksploruar këto opsione do të shpërblehen!
- **Zgjidhni problemet:** Shikoni problemet që kanë nevojë për zgjidhje, shërbimet që mund të jua lehtësojnë jetën, produktet që mungojnë në rafte, mënyrat që teknologjia mund t'i shpejtoj gjërat. Këto janë mundësitë tuaja për të bërë ndryshime.
- **Kërkoni vazhdimisht:** Ekzistojnë shumë punë, internshipe dhe mundësi trajnimi në vend, por nëse dëshironi t'i gjeni, ju duhet t'i kërkoni ato vazhdimisht.

Dhe së fundmi: **Besoni në mundësinë për sukses!** Si i ri në rajonin e Ballkanit, ju keni shumë përgjegjësi të mëdha – jeni ju ata që vendosni se si do të duket bota në të cilën do të rritën fëmijët tuaj. Besoni në një të ardhme më të mirë. Ju duhet ta bëni këtë.

Rreth konferencës Inovacionet e Mitrovicës 2016 – Zbulimi i Potencialit Rinor: MI2016 ka qenë konferencë interaktive me qëllim të frymëzimit të të rinjëve për të menduar në mënyrë kritike rreth karrierës dhe përgatitjes për të ardhmen e tyre.

Ngjarja ka bashkuar të rinjtë me ekspertët rajonalë dhe ndërkombëtarë, palët e interesit dhe partnerët nga fusha të ndryshme, përfshirë sektorët privatë dhe publik, akademinë dhe edukimin, për të ofruar një platformë për mendim inovativ. Të rinjtë patën mundësi të parashitjes pyetje, mësojnë dhe të eksplorojnë mundësitë me kolegët e tyre dhe mbikëqyrësit. Konferenca kishte synim të frymëzoj dhe inkurajoj rrjetin lokal dhe rajonal si dhe zhvillimin e karrierës të orientuar kah e ardhmja.

Rreth IBCM-së: Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë, ose IBCM, është një fondacion arsimor jofitimprurës i regjistruar ndërkombëtarisht dhe operon nën ombrellën e organizatës 'SPARK'. IBCM financohet nga qeveritë e Suedisë, Danimarkës, Holandës, Zvicrës, Bashkimit Europian si dhe Mbretërisë së Bashkuar. Si rezultat i lidhjeve tona të forta në Europë, programet e IBCM-së janë të dizajnuara për të ju përgatitur për çfarëdo karriere që synoni për veten – si lokalisht ose ndërkombëtarisht.

Ne ofrojmë diploma të akredituara ndërkombëtarisht 3.5 vjeçare dhe 2 vjeçare profesionale (AP) në:

- Shitje dhe Marketing Ndërkombëtar dhe Marketing & Menaxhment
- Menaxhim të Shërbimeve Publike dhe Administratë Publike
- Menaxhim Mjedisi dhe Bujaçësi

<http://ibcmitrovica.eu/>

Rreth Inovacioneve të Mitrovicës: Inovacionet e Mitrovicës është një seri konferencash të mbajtura nga Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë. Konferencat paraprake kanë përfshirë:

- Inovacionet e Mitrovicës 2014 – Mundësitë e Pakufizuara të Agrobiznesit?
- Inovacionet e Mitrovicës 2015 – Shkathtësi, Shkathtësi, Shkathtësi!
- Konferenca Ndërkombëtare Shkencore Inovacionet e Mitrovicës 2015: Roli i Biznesit në Zhvillimin e Qëndrueshëm në Ballkanin Përendimor

81%
SHKALLA E
PUNËSIMIT



APLIKO TANI!
www.ibcmitrovica.eu

Numri kontaktues: +381(0)28 409 013
+381(0)65 250 34 14

Adresa elektronike: info@ibcmitrovica.eu



International
Business College
Mitrovica

From Theory To Practice